

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Vahid Halili, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Fillim Skoro, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.K, S.J, dhe N.S nga Prizreni për shkak të veprës penale kontrabandimi me emigrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 te KPRK-se, te akuzuarit S.J dhe N.S edhe për shkak te veprës penale kotrabandimi me migrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se dhe i akuzuari N.S edhe për shkak te veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 120 par.38 te KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës se Prokurorisë Speciale te Republikës se Kosovës dhe ankesave te mbrojtësve te akuzuarve te ushtruara kundër aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Gjilan PKR.nr 115/15 të datës 29.09.2015, në seancën e Kolegjit të mbajtur konform nenit 390 par 1 të KPPRK - së, më datë 11 shkurt 2016 mori këtë:

AKTGJYKIM

Me aprovimin e ankesave te mbrojtësve te akuzuarve **NDRYSHOHET** aktgjykimi i gjykatës themelore ne Gjilan PKR.nr.115/15, ashtu qe Gjykata e Apelit e Kosovës te akuzuarit A.K për veprën penale nen 1 te dispozitivit te aktgjykimit te atakuar i shqipton dënimin me gjobe prej 1500 (një mije e pesëqind) Euro si dhe dënim me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashte) muaj, te akuzuarit S.J, për veprën e njëjtë penale sipas dispozitivit 1 te këtij aktgjykimi i shqipton dënimin me gjobe ne shume prej 500 (pesëqind) Euro si dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse te akuzuarin N.S për veprën e njëjte penale sipas dispozitivit nen 1 te aktgjykimit te atakuar i shqipton dënim me gjobe ne shume prej 200 (dyqind) Euro dhe dënim me burg ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite. Te akuzuarit S.J dhe N.S për veprën penale nen 2 te dispozitivit te aktgjykimit te atakuar i'u shqipton dënime dhe atë te akuzuarit S.J dënim me gjobe ne shume prej 300 (treqind) Euro si dhe dënim me burg ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, ndërsa te akuzuarit N.S dënim me gjobe ne shume prej 100(njëqind) Euro dhe dënim me burg ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj. Te akuzuarit N.Sper veprën penale sipas dispozitivit nen 3 te aktgjykimit te atakuar i shqipton dënim me gjobe ne shume prej 100 (njëqind) Euro, e ne pajtim me nenin 80 te KPRK-se i gjykon te akuzuarin A.K me dënim unik me gjobe prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro te cilën gjobe i akuzuari duhet ta paguaj ne afat prej 3 (tre) muaj pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit si dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashte) muaj e ne te cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej datës 02.10.2014 deri me 29.09.2015.

Te akuzuarit S.J, shqiptohet dënimi unik me gjobe ne shume prej 800 (tetëqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2(dy) vjet e 3 (tre) muaj e ne te cilin dënim me burg do t'i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me date 29.09.2015.

Te akuzuarit N.S shqipton dënimin unik me gjobe ne shume prej 400 (katërqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 3 (tre) muaj e ne te cilin dënim me burgim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me date 22.04.2015.

Ankesa e Prokurorisë Speciale te Republikës se Kosovës refuzohet si e pabazuar.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore ne Gjilan PKR.nr.115/15 te datës 29.09.2015, i akuzuari A.K është shpallur fajtor për veprën penale kontrabandimi me emigrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 2000 (dy mije) Euro e te cilën gjobe është obliguar qe ta paguaj ne afat prej 3 (tre) muajve pasi qe aktgjykimi te behet i plotfuqishëm si dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashte) muaj e ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me 29.09.2015. I akuzuari S.J është shpallur fajtor për veprën penale kontrabandimi me emigrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 1000 (një mije) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite dhe për veprën penale kontrabandimi me migrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 500 (pesëqind) Euro dhe dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj .I akuzuari N.S është shpallur fajtor për veprën penale kontrabandimi me migrante nga neni 170 par.5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 300 (treqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, për veprën penale kontrabandimi me emigrante ne bashkëkryerje nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobë ne shume prej 200(dyqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 120 par.38 te KPRK-se, për te cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 100(njëqind) Euro.

Për veprat penale te kryera gjykata e shkalles se pare konform nenit 80 te KPRK-es u ka shqiptuar dënime unike me gjobe dhe me burgim dhe atë

Te akuzuarit A.K dënim me gjobe ne shume prej 2000(dymijë) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 4(katër) vite e 6 (gjashte) muaj ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me date 29.09.2014.

Te akuzuarit S.J dënim me gjobe ne shume prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 4(katër) muaj ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me date 29.09.2015.

Te akuzuarit N.S dënim me gjobe ne shume prej 600 (gjashtëqind) Euro dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3(tre) vite e 2 (dy) muaj e ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 02.10.2014 deri me date 22.04.2015.

Te akuzuarit janë obliguar qe ne mënyrë solidare te i paguajnë shpenzimet e procedure penale sipas llogarisë përfundimtare te gjykatës dhe ne emër te paushallit gjyqësor secili veç e veç shumen prej nga 50(pesëdhjetë) Euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Te akuzuarit N.S konform nenit 62 te KPRK-se është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i 37(tridhete e shtate) fishekëve te armës automatike kallashnikov.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kane paraqitur :

Prokuroria Speciale e Republikës se Kosovës, për shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar te Gjykatës Themelore ne Gjilan ta ndryshoje dhe te akuzuarve A.K dhe S.J për veprat penale te kryera te i'u shqiptoje dënime me te larta me burgim.

Mbrojtësi i te akuzuarit A.K av.M.M per shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar te Gjykatës Themelore ne Gjilan ta ndryshoje dhe te akuzuarit A.K te i shqiptoj dënim me te ulet me burg dhe me gjobe, e me te cilin dënim do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me neni 41 te KPRK-se. Mbrojtësi i te akuzuarit gjithashtu me përgjigje ne ankese ka propozuar qe ankesa e PSRK-se te refuzohet si e pabazuar.

Mbrojtësi i te akuzuarit S.J, av.R.S, për shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar te Gjykatës Themelore ne Gjilan ta ndryshoje dhe te akuzuarit S.J te i shqiptoj dënim me te ulet me burg dhe me gjobe, e me te cilin dënim do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me neni 41 te KPRK-se.

Mbrojtësi i te akuzuarit N.S, av.B.N për shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar te Gjykatës Themelore ne Gjilan ta ndryshoje dhe te akuzuarit N.S te i shqiptoj dënim me te ulet me burg dhe me gjobe, e me te cilin dënim do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me neni 41 te KPRK-se.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën e vet PPA.nr.572/15 te datës 23.12.2015, duke u deklaruar lidhur me ankesat e PSRK-se dhe ankesat e mbrojtësve te akuzuarve ka propozuar qe ankesa e PSRK-se te aprovohet si e bazuar ndërsa ankesat e mbrojtësve te akuzuarve te refuzohen si te pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 te KPPRK-es ,ne te cilën prezantuan te akuzuarit A.K, S.J dhe N.S si mbrojtësit e tyre av.M.M, av.R.S, dhe av.B.N, ndërsa palët e tjera nuk prezantuan edhe pse te njëjtat ishin ne njoftuara ne mënyre te rregullt andaj seanca u mbajt konfrom nenit 390 par.4 te KPPRK-se. Te akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre mbeten pranë pretendimeve nga ankesat e ushtruara me shkrim duke propozuar qe te njëjtat te aprovohen.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-se dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa dhe përgjigje në ankese, dhe gjeti se :

- ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara ndërsa ajo e PSRK-se nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPRK-se dhe konstatoi se i njëjti aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjithashtu, gjendja faktike e konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, ngase gjendja e konstatuar faktike nuk është kundërshtuar me ankesa, ndërsa e njëjta është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lendes. Nga kjo del se në rastin konkret nga ana e gjykatës së shkallës së parë, drejte është aplikuar edhe ligji penal, kur është konstatuar se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat janë akuzuar dhe shpallur fajtor.

Në ankesën e PSRK-se , lidhur me vendimin mbi sanksionin penal pretendohet se dënimet e shqiptuara unike të akuzuarve A.K dhe S.J për veprat penale të kryera janë të ulëta dhe janë në disproporcion me peshën e veprave penale të kryera si dhe shkallen e rrezikshmërisë shoqërore, andaj me dënimet unike të shqiptuara nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 të KPRK-se, ngase të njëjtat nuk janë adekuate dhe janë joproporcionale me veprat penale të kryera.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësve të akuzuarve të njëjtit me ankesat e tyre pretendojnë se dënimet e shqiptuara të akuzuarve janë të larta duke patur parasysh se të akuzuarit kanë shprehur keqardhje për veprat penale të kryera, kanë pranuar fajësinë, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale andaj konsiderojnë se ankesat e tyre janë të bazuara dhe se ka vend që t'u shqiptohen dënime me të ulta me burg dhe me gjobe e me të cilat dënime do të arrihej qëllimi i dënimit.

Prandaj duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata e Apelit e Kosovës, gjeti se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara dhe ndryshoi aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal, duke u zvogëluar dënime të akuzuarve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e me bindje se me dënime të tilla të shqiptuara me burg dhe me gjobe do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 të KPRK-se, parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe se këto dënime do të jenë në shërbim të preventives së përgjithshme e sidomos të asaj të posaçme në forcimin e moralit të shoqërisë, dhe gjykimi shoqëror për veprat penale, dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga te cekurat e me larta, e ne baze te nenit 403 te KPPK-se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykim

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË,
PAKR.nr. 602/15 të datës 11.02.2016**

**Procesmbajtesi
Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,
Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i kolegjit.
Vahid Halili**

Fillim Skoro
